



Биологија - Албански

EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
BIOLOGJI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE

VENDI

KOMUNA

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 220202511262

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik dhe gomë, por nuk mund ta përdorësh kalkulatorin dhe telefonin mobil.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuar.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet (), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat të cilat kanë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
☐ Novi Sadi ☒ Beogradi ☐ Nishi ☐ Krushevc	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrathët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
☒ $2 + 3$ ☐ $1 + 2$ ☒ $4 + 1$ ☐ $2 + 4$ ☐ $3 + 5$	

- Nëse e përfundon testin më herët se sa koha që është paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!



PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR
TESTI
BIOLOGJI

1. Për shkak të cilave dukuri laraska i takon qenieve të gjalla?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ mund të fluturojë ☐ liron tinguj
- ☐ ka pamje ☐ zhvillohet me anë të vezëve
2. Te cilat organizma të poshtëpërmendur është i pranishëm procesi i polenizimit?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ kërpudhat shampinjon ☐ vjedulla ☐ bliri ☐ meduza
3. Ku zbërthehen grimcat e ushqimit të cilat depërtojnë në hapësirën e brendshme të Euglenës së gjelbërt?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ në kloroplaste ☐ në vakuolën kontraktuese
- ☐ në vakuolën ushqyese ☐ në bërthamë
4. Përmes cilës pjesë të trupit bëhet shkëmbimi i gazrave të skrraja e shiut?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ verëzave ☐ lëkurës (sipërfaqes së trupit) ☐ mushkërive ☐ gojës së hapur
5. Cili organ i njeriut e ka rolin në pastrimin e gjakut dhe krijimin e urinës?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ fëshikëza urinare ☐ veshka
- ☐ zorra e hollë ☐ mëlçia
6. Cila është rruga e saktë e ajrit gjatë frymëmarrjes?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ vrima e hundës, trakea, fyti, mushkëritë
- ☐ vrima e gojës, fyti, mushkëritë, trakea
- ☐ vrima e hundës, fyti, trakea, mushkëritë
- ☐ vrima e gojës, mushkëritë, trakea, fyti





7. Kur dhelpira e ndjek lepurin në mal, ajo harxhon energji. Në çfarë forme ajo do ta rikuperoj energjinë e humbur? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ me pushim pas gjuajtjes ☐ me ngadalësim të lëvizjeve
☐ me anë të gjumit ☐ me ushqyerje

8. Cili nga shembujt e dhënë paraqet shumimin? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ ndarja e sfungjerëve ☐ ndarja te bakteret
☐ bashkimi i gameteve te karkaleci ☐ shumimi vegjetativ te lulevjollca

9. Çka kanë të përbashkët qelizat ashtërore, lëkurore dhe nervore në trupin e njeriut? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ formën ☐ funksionin ☐ materialin trashëgues ☐ madhësinë

10. Përderisa pohimi për organizmat bimorë është i saktë, ngjyros rrethin në kolonën SAKTË, e nëse pohimi nuk është i saktë, atëherë ngjyros rrethin në kolonën PASAKTË.

Pohimi	SAKTË	PASAKTË
Qelizat kan mur qelizor.	☐	☐
Në qelizë janë të pranishme vakuolat të cilat e ruajnë ujin dhe kripërat minerale.	☐	☐
Në organizimin e trupit ekzistojnë sistemet e organeve.	☐	☐

11. Cila shtazë i ushqen të vegjëlit e saj me përmbajtjen e cila gjendet në gjëndrat e qumshtit? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ krapë ☐ dallëndyshja ☐ breshka ☐ shimpanza

12. Cila bimë e ka gjethen të ndërtuar ashtu që forma e saj dhe numri i stomeve tregojnë që transpirimi është dukshëm më i ulët në krahasim me bimët e dhëna? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ detelina ☐ bungu ☐ pisha ☐ misri





13. Organizmat e kanë aftësinë e vetrregullimit të procesit të rikthimit në gjendje normale, karakteristike për perioda të caktuara para ndodhjes së ndonjë ndryshimi në ndërtimin ose funksionin e tyre. Si quhet ky mekanizëm? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ cikël qelizor ☐ metabolizëm qelizor
- ☐ homeostazë ☐ regjenerim
14. Në një mal të lisit termitet ushqehen me qukapiktha të cilët janë gjahu i dhelprave. Gjethet e lisit i konsumojnë krimbat të cilat janë gjah i zogjëve këngëtarë. Zogjtë këngëtarë janë gjah i dhelprave. Çfarë përshkruan teksti i dhënë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ formë jetësore ☐ nishën ekologjike
- ☐ rrjetën e të ushqyerit ☐ biotop
15. Filikatja e pyllit është një banorë e shpeshtë e pyjeve të ahut dhe pyjeve të bungut e haset gjithashtu edhe në pyjet halore. I takon familjes së zhabinorëve gjë e cila është karakteristikë edhe e shumë llojeve të këtij grupi, rradhitet në bimët helmuese dhe substanca nga gjethet dhe lulet e saj mund të shkaktojnë pengesë në funksionimin normal të sistemit nervor. Në këtë tekst të shkurtër janë përmendur disa nivele të organizimit të botës së gjallë. Cili nga opsionet e përmendura bënë përjashtim? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ organi
- ☐ sistemi i organeve
- ☐ biocenoza
- ☐ ekosistemi



16. Çka paraqet vaksina kundër tuberkulozit? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ imunitet aktiv natyror
- ☐ imunitet pasiv natyror
- ☐ imunitet aktiv artificial
- ☐ imunitet pasiv artificial





17. Cila nga karakteristikat e mëposhtme i mungon kërpudhave?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

☐ ndërtimi qelizor ☐ aftësia për shumim
☐ organizimi shumëqelizorë ☐ procesi i frymëmarrjes

18. Disa nga indet e përmendura i kanë vetëm bimët derisa shtazët nuk i kanë. Cili nga indet e dhëna bënë përjashtim?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

☐ të fshehtë ☐ të dyfishtë ☐ të përhershëm ☐ palisad

19. Për secilin proces ndaje se si ndikon në variabilitetin (shumëllojshmërinë) e një populacioni.
Ngjyros rrethin te fusha e caktuar.

	E rrit variabilitetin	E zvoglon variabilitetin
Mutacionet	☐	☐
Emigrimet	☐	☐
Seleksioni natyror	☐	☐

20. Në parkun nacional Yellowstone është zvogëluar numri i populacionit të ujqërve, e cila ka çuar deri te ndryshimi në numrin e populacionit të drenushave. Kjo joparazpeshë ka çuar deri te rirradhitja e pyjeve të shelnjes në parkun nacional. Cili reagim do t'ia rikthejë dendësinë pyllit të shelnjes dhe gjendjen e mëhershme?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

☐ mbjellja e bimëve të reja të shelnjes
☐ mbjellja e bimëve të reja
☐ pruarja e ujqërve të rinj
☐ pruarja e drenushave të reja



FAQE E ZBRAZËT



Биологија - Албански



ИНТЕPHO

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI

BIOLOGJI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE
VENDI
KOMUNA

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

